Nr: 2930 Prot
dt: 18.09.2025

X Kryesekretaria
18.09.'25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 988/1 Prot

Shkodër, më 18.09.2025

**Lënda: Përcjellje e kritereve të pranimit në programin e ciklit të dytë Master Shkencor"Marketing Inovativ".**

**Prof.as.dr. Eliana Laçej**

**Zv.Rektore e Universitetit të Shkodrës"Luigj Gurakuqi"**

Bashkëngjitur kësaj shkrese ju përcjellim kriteret e pranimit në programin e ciklit të dytë Master Shkencor"Marketing Inovativ".

Kjo shkresë përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë.

**DEKANI**

**Prof.as.dr. Elidiana BASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TURIZËM

Nr.988 Prot

Shkodër, më 18.09.2025

**LËNDA: Kriteret e pranimit në programin e ciklit të dytë Master Shkencor „Marketing Inovativ"**

**Drejtuar: Dekanes së Fakultetit Ekonomik -Prof.as.Dr. Elidiana Bashi**

Departamenti i Turizmit me vendimin nr.145 datë 12.10.2023 ka propozuar kriteret e mëposhtme të pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve Master shkecnor në "Marketing Inovativ":

a) Të ketë përfunduar me sukses një program të ciklit të parë Bachelor në një Institucion të Arsimit të Lartë të akredituar dhe që janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë. Për kandidatët që janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë të studimit, në një institucion të arsimit të lartë të akrdituar duhet që diploma e tyre të jetë e njehsuar dhe e njohur në QSHA.
b) Të zotërojë një çertifikatë, diplomë apo dëshmi, të lëshuar nga subjekete të njohura nga Ministria përgjegjëse e arsimit, që ofrojnë teste ndërkombëtare të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e cila dëshmon njohjen nga kandidati të paktën në nivel B1 të një prej këtyre gjuhëve. Nëse individi ka fituar diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
c) Në rast se numri i aplikimeve do të jetë më i madh se numri i kuotave të pranimit atëherë kandidatët aplikues do të renditen sipas notës mesatare të ciklit të parë të studimeve.

**Përgjegjëse e njësisë bazë Turizëm**

**Prof. Dr. Arjeta Troshani**